



Pranuar / Dorezuar Priljeno/Prodato Received/Delivered	15.03	2021	viti god year
Organ /Njesia Organ /Jedinica Org /Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtesa Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKIMSHICK	1154/2021		113



## Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.57/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari-kryetare, Arben Mehmeti dhe Eshref Shabani-anëtarë dhe Ardita Perçuku-Shyti-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.57/2021 të datës 04.02.2021, të parashtruar nga ankuesja me adresë rruga "Sadik Pozhegu"Nr.3, nga Komuna e Gjakovës, kundër organit të punësimit/Policia e Kosovës, në çështjen juridike "kompensim material" duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës , në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 15.03.2021, mori këtë:

### V E N D I M

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Shpallet jo kompetent për të vendosur për ankesën me numër A.nr.57/2021 të datës 04.02.2021 të parashtruar nga ankuesja

### A r s y e t i m

Ankuesja e punësuar në Policinë e Kosovës sipas, sipas vendimit me numër Nr.07/1-01A/7225, të datës 07.10.2015, ne pozitën "Radiokomunikues" në Divizionin e Sigurisë Publike, në Stacionin Policor në Gjakovë, me datë 04.02.2021 ka parashtruar ankesë me Nr. Prot:462/2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore për kompensim material nga pakoja emergjente COVID-19 për muajin qershor, korrik, gusht, shtator, tetor, nëntor dhe dhjetor të vitit 2020.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 05.02.2021, ka dërguar kërkesë për përgjigje në ankesën e ankueses tek Policia e Kosovës. Policia e Kosovës me datën 04.03.2021 , ka dërguar provat e kërkuara.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vendosjen në mënyrë meritore, ka administruar këto prova: Ankesën me Nr. Prot:462/2021 e datës 04.02.2021 e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Raporti i vijueshmërisë për muajin dhjetor, nëntor, tetor, shtator, gusht, korrik ,qershor 2020; Kontratë



e marrëdhënies së punës 24.04.2006; Vendim i datës 15.01.2021 i Komisionit për Ankesa i Policisë së Kosovës; Vërtetim punësimi i datës 03.02.2021; Kontrata e marrëdhënies së punës së ankueses e datës 16.10.2008; Kërkesa për përgjigje në ankesë e datës 05.02.2021 nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Përgjigja në ankesë e datës 04.03.2021 nga Policia e Kosovës; Kontrate e marrëdhënies së punës së ankueses e datës 08.04.2004; Formulari -PDP për përshkrimin e detyrave të punës për pozitën Radiokomunikues i datës 04.09.2015; Ankese e ankueses e datës 12.11.2020, drejtuar Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Policisë së Kosovës; Vendim i datës 15.01.2021 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Policisë së Kosovës; E-maili zyrtar i datës 26.02.2021; Vijueshmëria për muajin janar 2021; Vijueshmëria për muajin mars, prill, maj, qershor, korrik, gusht, shtator, tetor, nëntor, dhjetor të vitit 2020; Vendim i datës 25.09.2020 me numër Nr.02/32 i Qeverisë së Republikës së Kosovës; Vendim i datës 24.12.2020 me numër Nr.02/52 i Qeverisë së Republikës së Kosovës; E-maili zyrtar i datës 18.02.2021; E-maili zyrtar i datës 09.02.2021; E-maili zyrtar i datës 11.01.2021.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, duke shqyrtuar të gjitha provat e lëndës, konstaton se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, *nuk është kompetent* për të vendosur për ankesën e parashtruar nga ankuesja *sepse:*

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, duke i'u referuar dëshmi të ofruara nga ankuesja dhe organi i punësimit, konstaton se ankuesja është në marrëdhënie punë në Policinë e Kosovës respektivisht në Stacionin Policor në Gjakovë sipas vendimit të datës 07.01.2015 në pozitën "Radiokomunikues" dhe në bazë të përshkrimit të detyrave të punës ankuesja kryen këto detyra "I pranon dhe i shpërndan informata hyrëse dhe dalëse nga zyra e komunikimit. Kujdeset për regjistrimin, sistemin dhe shpërndarjen e informatave. Mban shënime dhe kujdeset për veprimet e patrullave. Pranon të gjitha thirrjet dhe i shpërndan informatat. Angazhimi për mbajtjen e komunikimit të nevojshëm me Departamentit/Drejtoritë dhe njësitë tjera të Policisë së Kosovës. Mban kontakt me institucionet e ndryshme brenda territorit që kujdeset stacioni apo njësia. Kujdeset për sigurimin e të dhënave të kërkuara për njësitë patrulluese në terren. Bënë verifikimin e personave të dyshuar në listat përkatëse. Bënë verifikimin e veturave (për regjistrim, vjedhje, aksident etj). Kryen edhe punë tjera që ja përcakton mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore të cilat me arsye mund të kërkojnë kohë pas kohe e të cilat nuk cenojnë dinjitetin e punonjësit".

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave duke ju referuar nenit 2 paragrafit 2 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrat e Publikë, i cili përcakton se zyrat e publikë ndahen në: *nëpunës të Shërbimit Civil (në tekstin në vijim: nëpunësi civil); nëpunësi i Shërbimit Publik; nëpunësi i Kabinetit; dhe nëpunës administrativ dhe mbështetës*, si dhe duke ju referuar detyrave të punës që kryen ankuesja nga pozita "Radiokomunikues", konstaton se të punësuarit që kryejnë veprimtari ndihmës dhe të mirëmbajtjes, në bazë të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrat e Publikë nuk i takojnë shërbimit civil respektivisht janë kategorizuar si nëpunës administrativo-technik - dhe mbështetës ashtu siç përcaktohet me nenin 2 paragrafin 6 ku theksohet se: *6. Nëpunës administrativo-technik - dhe mbështetës është zyrtari publik, që kryen veprimtari ndihmës, të mirëmbajtjes, ruajtjes, vozitjes, si dhe veprimtari të tjera të ngjashme në institucionet e administratës publike*. Andaj, duke marrë parasysh se ankuesja tanimë me Ligjin Nr.06/L-114 për Zyrat e Publikë i përket kategorisë së nëpunësve administrativo-technik dhe





mbështetës, Kolegji vlerëson se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nuk është kompetent për të vendosur për nëpunësit me status të shërbimit administrativo-teknik dhe mbështetës.

Ndërlidhur me këtë pjesë VII e Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, ka trajtuar në mënyrë të detajuar marrëdhënien e punës së nëpunësit administrativ dhe mbështetës, ku neni 82 i këtij ligji, përcakton se: *"Përveç sa parashikohet shprehimisht ndryshe në nenet 79 deri 81 të këtij ligji, marrëdhënia e punës e nëpunësit administrativ dhe mbështetës i nënshtrohet legjislacionit të punës"*, mbi këtë bazë dhe duke ju referuar dispozitave të nenit 6 paragrafit 1 nën paragrafit 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil i Kosovës, nuk është kompetent për të vendosur për ankesën e parashtruar nga ankuesja, sepse Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil i Kosovës shqyrton dhe merr vendime për ankesat e nëpunësve civil dhe kandidatëve për pranim në shërbimin civil.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, meqenëse ka konstatuar se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nuk është kompetent për vendosur për ankesën e parashtruar nga ankuesja, atëherë udhëzon palën për ushtrimin e mjeteve juridike sipas nenit 24 paragrafit 4 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, i cili përcakton se: *"Nëpunësi i Shërbimit Publik dhe nëpunësi administrativ dhe mbështetës kanë të drejtë të ankohen sipas këtij ligji të punëdhënësi dhe më pas mund të fillojë kontest administrativ në gjykatën kompetente"*.

Duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe provat e bashkëngjitura në lëndë, Kolegji për shqyrtimin e ankesave, bazuar në nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**Lënda me numër A.nr.57/2021**

**Ardita Perçuku-SHYTI**

Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional

**Malsore GASHI-BAJRAKTARI**

Kryetare e Kolegjit

**Vendimi i dorëzohet:**

- Ankueses
- Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Kosovës;
- Udhëheqësit të Personelit në Policinë e Kosovës;
- Komisionit të Ankesave të Policës së Kosovës dhe
- Arkivit të KPMSHCK- së.

